

VENDIM
Nr. 29, datë 20.6.2019

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-
KANALIZIME TROPOJË SHA**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.6.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë (UK Tropojë) me shkresë nr. 119 prot., datë 19.12.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime”, ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rritjen e tarifave në zonën e shërbimit për të tre kategoritë e konsumatorëve të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse të shoqërisë UK Tropojë në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 6, datë 1.2.2019, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Tropojë për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.”

3. Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë ka paraqitur dokumentacionin e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU me shkresë nr. 119 prot., datë 19.12.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime”, për të tre kategoritë e konsumatorëve sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve:

Kategoritë e Konsumatorëve	Tarifat aktuale		Tarifat e propozuara	Diferenca
	Tarifat sipas vendimit të KKRR nr. 29, datë 13.10.2004	Tarifat që ka zbatuar deri tani me miratimin e Këshillit Mbikëqyrës	Për zonën e shërbimit të riorganizuar	Propozimi i shoqërisë: tarifat aktuale sipas Këshillit Mbikëqyrës
A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	lekë/m ³	lekë/m ³	lekë/m ³	lekë/m ³

1. Konsumatorë familjarë (zona urbane)	19	29.2	40	+10.8
1/1. Konsumatorë familjarë (zona rurale)	19	15.8	40	+24.2
2. Konsumatorë publik	60	50	90	+40
3. Konsumatorë privat	80	66.7	100	+33.3
B. Tarifë volumetrike për KUN	lekë/m ³	lekë/m ³	lekë/m ³	lekë/m ³
1. Konsumatorë familjarë	-	-	13	
2. Konsumatorë publik	-	-	22	
3. Konsumatorë privat	-	-	22	
C. Tarifë fikse e shërbimit	lekë/muaj/1 idhje	lekë/muaj/li dhje	lekë/muaj/li dhje	lekë/muaj/li dhje
1. Konsumatorë familjarë	-	83	100	+17
2. Konsumatorë publik	-	83	200	+117
3. Konsumatorë privat	-	83	200	+117

Ligjërisht, shoqëria duhet të aplikojë tarifat e miratuara nga ERRU-ja sipas vendimit nr. 29, datë 13.10.2004 “Për miratimin e tarifave për konsum publik të sh.a. Ujësjetllës Tropojë”, por aktualisht referuar vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. ekstra, datë 29.12.2013¹ “Për kategorinë e konsumatorëve familjarë për zonën urbane (qyteti Bajram Curri) aplikon tarifën volumetrike 29.2 lekë/m³.”

Pikërisht, nisur nga kjo shkelje ligjore, Enti Rregullator i Ujit ka inspektuar këtë shoqëri në datë 10.5.2018, bazuar në Rregulloren e Inspektimit. Ndaj shoqërisë u mor masë administrative, gjobë në shumën 100.000 lekë, për moszbatim të vendimeve të Entit Rregullator të Ujit.

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se treguesit e arritur të performancës për vitin 2017 dhe objektivat e propozuar nga shoqëria UK Tropojë për vitin 2019 janë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me treguesit kryesorë të performancës për vitet 2017–2018–2019

Treguesit e performancës	Njësia matjes e	Treguesit e performancës		
		Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Mbulimi i kostove direkte të O&M	%	83	84	98
Mbulimi i kostove totale	%	63	60	76
Uji pa të ardhura	%	68.8	64.7	64
Mbulimi me ujë	%	43.6	47.1	51.3
Mbulimi me KUN	%	0	0	29.8
Niveli i matjes	%	72	75	80
Norma e arkëtimit korrente	%	58	63	71
Vazhdimësia e furnizimit me ujë (vetëm për njësitë ku shërbehet)	orë/ditë	10	20	22
Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	14.8	16	10.4

Në metodologjinë e vendosjes së tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura, miratuar me vendimin e KKRR-së nr. 42, datë 9.12.2015, në nenin 16 të saj “Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife – periudha tranzitore” citohet: “Për propozimin e parë për ndryshimin e tarifës, brenda periudhës tranzitore, për rastet kur shtohet një zonë e re si pjesë e zonës së shërbimit të operatorit, sipas kësaj metodologjie do të bëhet vetëm analiza e kostos. Më tej,

¹ Sipas këtij vendimi është përcaktuar një tarifë afrore me TVSH 800 lekë/muaj/klient familjarë. Në atë periudhë të gjithë klientët ishin pa matës dhe kjo situatë ka qenë deri në vitin 2016. Me vendosjen e matësve, nisur nga kjo tarifë afrore e cila i korrespondonte një familje me 5 persona shoqëria ka llogaritur tarifën volumetrike 29.2 lekë/m³ të cilën e aplikon për zonën urbane.

ERRU-ja do të përcaktojë një grup treguesish bazë performance për çdo operator, të cilët do të shërbejnë si referencë dhe do vlerësohen gjatë ndryshimeve të tarifave për periudhat në vazhdim”.

Nisur nga sa më sipër, UK Tropojë është një shoqëri e re e riorganizuar, që aplikon për herë të parë sipas kësaj metodologjie. Shoqëria UK Tropojë bën pjesë në grupin e shoqërive që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, prandaj përmirësimi i këtij treguesi është objektiv kryesor i shoqërisë për vitin 2019.

Nevoja e ndryshimit të tarifave nga ana e UK Tropojë me qëllim gjenerimin e të ardhurave shtesë argumentohet si më poshtë, të cilat vlerësohen nga ERRU-ja:

a) Pas zgjerimit të zonës së shërbimit Shoqëria aplikon për herë të parë sipas metodologjisë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, bazuar në analizën e gjendjes teknike dhe ekonomike të saj, konkretisht analizën e kostove dhe të ardhurave për shërbimet e ofruara, analizën dhe përcaktimin e objektivave për treguesit e performancës.

b) Shoqëria aplikon për miratimin e nivelit të ri tarifor pas një periudhe 15-vjeçare (aplikimi i fundit në vitin 2004) duke propozuar unifikim dhe rritje të tarifës volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizime, si dhe të tarifës fikse të shërbimit për të tri kategoritë e konsumatorëve.

c) Përmirësimin e nivelit aktual të mbulimit të kostove O&M me synimin drejt mbulimit 100%.

d) Shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve. Referuar pasqyrave financiare 2017 këto detyrime janë në shumën 57,6 milionë lekë të cilat duhet të përballohen me tarifa por dhe me subvencione nga ana e qeverisë.

e) Përballimin e riparimeve në rrjetin e ujësjellësit, pasi raportohen defekte të shumta.

f) Blerjen e matësve individualë me qëllim përmirësimin e treguesit “Niveli i matjes”.

g) Mundësinë e implementimit të sistemit kompjuterik për faturimet, pasi aktualisht mbahet në mënyrë manuale.

h) Marrja e shërbimit të kanalizimeve nga UK Tropojë, për qytetin Bajram Curri kërkon kosto shtesë për të përballuar këtë shërbim.

i) Shoqëria synon realizimin e një objektiv ambicioz për rritjen e orëve mesatare të furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë zonën e shërbimit nga 10 orë në vitin 2017, në 22 orë në vitin 2019.

j) Përmirësimi i nivelit të humbjeve nëpërmjet investimeve të vogla nga vetë shoqëria, kryesisht në zonën rurale ku dhe humbjet e ujit janë më të mëdha, si dhe nëpërmjet legalizimit të lidhjeve të paligjshme.

k) Subvencionimi nga ana e qeverisë ka qenë në shuma të pa konsiderueshme referuar nevojave të shoqërisë, të cilat kanë shkuar për shlyerjen e kostove të energjisë elektrike. Për vitet 2017 dhe 2018 janë përfituar përkatësisht nga 3 milion lekë.

5. ERRU, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr.42, ka kërkuar nga UK Tropojë informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

6. ERRU, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tropojë të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për mos lejin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, (ligji nr. 9902);

d) orientimin drejt mbulimit të kostove O&M në nivelin 98% pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që mbulon 83% të këtyre kostove.

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifat duhet të jenë të përballueshme.

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

g) propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar për sa i përket tarifave volumetrike për dy shërbimet ujë dhe kanalizime, si dhe tarifën fikse të shërbimit.

7. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

a) Të ndjekë në mënyrë periodike ecurinë sipas planit të kostove dhe të ardhurave me qëllim realizimin e treguesit “Mbulimi i kostove O&M” në nivelin e parashikuar.

b) Të shlyej në kohë detyrimet ndaj shtetit dhe të tretëve me qëllim që të paguajë vetëm kostot e nevojshme dhe jo kostot shtesë të pajustificuara.

c) Të hartojë plan veprimi për arkëtimin e debive të prapambetura duke ndjekur dhe hapat ligjorë për sistemimin e llogarive të klientëve pa shpresë kthimi me qëllim që në të ardhmen të arrijë të planifikojë provizionime për mbylljen e tyre.

d) Të intensifikojë përpjekjet për rritjen e përqindjes së arkëtimit korrent të faturave të vitit, me qëllim që norma e arkëtimit korrent për vitin 2019 të arrijë nivelin 75%.

e) Të shikojë mundësinë e hartimit të një Plan Biznesi me qëllim përcaktimin e synimeve, si dhe rrugët për arritjen e tyre, përcaktimin e nevojës për të ardhura, si dhe nivelin tarifor për një periudhë 5 vjeçare.

f) Shoqëria detyrimisht në vitin 2020 duhet të mbajë në kontabilitet me qendra kostoje të ndara për shërbimin e furnizimit me ujë dhe ato të kanalizimeve të ujërave të ndotura, në mënyrë që tarifat të orientohen drejt kostove përkatëse.

g) Të pajiset me matës të mëdhenj në të gjitha pikat e prodhimit të ujit, si dhe në pikat kryesore të rrjetit.

h) Të ngrejë task-forcën për gjetjen dhe eliminimin e të gjitha lidhjeve të paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes.

i) Për të hartuar Bilancin e Ujit sa më real, në të gjithë nën zërat e tij, duhet të mbajë evidenca mbi defektet e ndodhura gjatë vitit në sistemin e furnizimit, të përlllogaritë sasitë e humbura të ujit para riparimit dhe gjatë riparimit. Gjithashtu gjatë periudhës që shoqëria nuk ka të instaluar matës në prodhim, duhet të mbajë regjistra ku të pasqyrohet sasia ditore e ujit që prodhohet bazuar në treguesit e pompave në operim dhe numrit të orëve të punës së tyre.

j) Të fillojë procesi i identifikimit fizik të asetëve për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime pasi ka mungesë informacioni lidhur me to (sidomos për shërbimin me kanalizime ku asetet janë vetëm në vlerë monetare) në mënyrë që të mundësohet hartimi i Planit të Menaxhimit të Aseteve.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjorë referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Tropojë si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas njësive administrative	
	Bajram Curri	Bujan, Bytyc Fierzë, Llugaj, Margega, Tropojë, Lekbibaj
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lekë/m ³	Lekë/m ³
Konsumatorë familjarë	40	30

Konsumatorë publik	80	80
Konsumatorë privat	80	80
Tarifë volumetrike për KUN	Lekë/m ³	Lekë /m ³
Konsumatorë familjarë	13	-
Konsumatorë publik	22	-
Konsumatorë privat	22	-
Tarifë fikse	Lekë /muaj/lidhje	Lekë /muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	100	100
Konsumatorë publik	100	100
Konsumatorë privat	100	100

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës të vitit 2019, për shoqërinë UK Tropolje të jenë:

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit të përcaktuar nga ERRU-ja
Mbulimi i kostove O&M	%	94.4
Uji pa të ardhura	%	58
Niveli i matjes	%	93
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	22
Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	10
Mbulimi me ujë	%	54
Mbulimi me KUN	%	30
Norma e arkëtimit korente	%	75

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Tropolje sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Tropolje brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Vendimi nr. 29, datë 13.10.2004 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. Ujësjellës Tropolje”, shfuqizohet.

6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.8.2019 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani